



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.16, datë 16.01.2023

PËR
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Zonja Elidjana Kasa, aktualisht prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Zonja Elidjana Kasa do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, nga data 25.01.2023 deri më 24.04.2023.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zonja Elidjana Kasa do të paguhet me pagën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
4. Të njoftohen për këtë vendim zonja Elidjana Kasa, Prokurori i Përgjithshëm Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 16.01.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Arta Mandro

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Ledina Riza